



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Doretuar Priljevoj/Prodato Received/Delivered	24.03.2023	3	Viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSK	2989	/2023	1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.152/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.152/2023 të datës 25.01.2023 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokat nga Prishtina, kundër Vendimit Nr.2100/2022 të datës 23.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 24.03.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.152/2023 e datës 25.01.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.2100/2022 i datës 23.12.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, më datë 25.01.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.2100/2022 të datës 23.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me pretendimet ankimore së vendimi i kundërshtuara me ankesë është nxjerrë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi dhe aplikim të gabuar të dispozitave procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën të Instituti i Kosovës për Administratë Publike. Ndërsa, Këshilli më datë 02.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendim me numër protokollit 2361/2023 të datës 06.03.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës edhe për 10 ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas kontaktimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 810/2023 të datës 25.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit e datës 18.11.2013 për ankuesin; Kërkesën për pushim pa pagesë e datës 15.02.2017 e parashtruar nga ankuesi; Vendimin me numër protokollit 036 i datës 23.02.2017 për aprovimin e pushimit mjekësor pa pagesë; Kërkesën për ndërprerjen e pushimit mjekësor pa pagesë e datës 23.05.2017 e parashtruar nga ankuesi; Vendimin me numër protokollit 230 i datës 08.06.2017 për ndërprerjen e pushimit mjekësor pa pagesë; Vendimin me numër protokollit 303 i datës 21.07.2017 për aprovimin e kërkesës për punë sekondare; Përgjigjen Ref. Nr.251/2021 e datës 13.04.2021 nga Kolegji AAB; Vendimin me numër protokollit 569 i datës 18.12.2020 për aprovim të kërkesës për punë sekondare me 20 orë në javë; Kërkesën për informatë e datës 12.03.2021; Kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore me numër protokollit 02-03/2278/22 të datës 26.05.2022 nga Agjencia Kudër Korrupsionit; Vendimin me Nr. 1202/2022 të datës 29.07.2022 të Komisionit Disiplinor i MPB-së për shtyrje të afatit në procedurë administrative; Vendimin Nr.1367/2022 të datës 29.08.2022 të Komisionit Disiplinor të MPB-së; Ankesën me numër protokollit 5681/2022 të datës 26.09.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 827/2022 i datës 22.11.2022 i Këshillit; Vendimin me Nr.2100/2022 i datës 23.12.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Librezë nga HANDIKOS për ankuesin; Vërtetimin re datës 26.01.2021 nga HANDIKOS për ankuesin; Ekspertizën për ankuesin për vlerësim mjekësor; Autorizimin e përfaqësuesit të datës 09.01.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 1475/2023 e datës 07.02.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 02.03.2022 me numër protokollit 2241/2023; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuese me numër protokollit 571 e datës 14.12.2022; Ftesë për seancë e datës 19.12.2022; Emailin e datës 19.12.2022 nga Personi MPB për ; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 21.12.2022, 22.12.2022; Emailin e datës 18.01.2023 nga Personi MPB për ankuesin; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Administratës në IKAP e datës 06.08.2012; Emailin e datës 13.12.2022 nga ankuesi për Emailin e datës 13.12.2022 nga për ankuesin; Vendimin me numër protokollit 020 të datës 04.10.2020 për aprovim të kërkesës për punë sekondare; Kartelën e nëpunësit nga vitit 2017 deri në vitin 2022; Formular për deklaram të pagës sekondare i datës 18.12.2020; Kërkese/Njoftim i datës 02.09.2019; Deklaratë nen betim nga Agjencia e Kosovës për Akreditim; Raporti i hyrje daljeve 01.01.2017-31.12.2027, 01.01.2018-31.12.2018, 01.01.2019-31.12.2019, 01.01.2020-31.12.2020, 02.10.2021-31.12.2021 dhe 02.01.2022 deri 09.12.2022; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil të Kosovës i datës 24.01.2021, 31.01.2022, 27.01.2022; Vendimin e datës 09.11.2022 për formimin e nën Komisionit për Vlerësim të Pasurisë jo financiare MPB/IKAP; Raport i planifikimit dhe realizmit të buxhetit të

IKAP për vitin 2021; Vërejtjen me shkrim me numër protokoll 602 e datës 20.12.2021; Vendimin A.nr.73/2022 i datës 28.03.2022 i Këshillit; Emailin e datës 08.03.2017 nga ankuesi; Emailin e datës 08.03.2017 nga [] për []; Emailin e datës 08.03.2027 nga E.H për D.M; Emailin e datës 06.03.2017 nga [] për [], CV-në e ankuesit; Vendimin me numër protokoll 01-4072/15 i datës 12.11.2015 i Agjencisë kundër Korrupsionit; Vendimin me numër protokoll 2361/2023 të datës 06.03.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës gjegjësisht sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 1965 të datës 18.11.2013, është konstatuar së ankuesi është i emëruar në pozitën e punës *Drejtor i Departamentit të Administratës*, në Institutin e Kosovës për Administratë Publike (më tej IKAP).

Me Vendimin me numër protokoll 303 të datës 21.07.2017 të Drejtores së Përgjithshme të IKAP-it është aprovuar kërkesa e ankuesit për punë sekondare në këtë institucion, ndërsa me Vendimin me numër protokoll 27.08.2018 ankuesit i miratohet kërkesa për punë sekondare në IKAP, për periudhën kohore nga 01.10.2018 deri me 01.09.2019 si dhe me vendimin më numër protokoll 020 të datës 04.10.2020 Drejtorja e Përgjithshme ka aprovuar kërkesën e ankuesit për punë sekondare në IKAP për periudhën nga 01.09.2019 deri në një vendim tjetër.

Me tej nga provat e kësaj çështje rezulton së Drejtorja e Përgjithshme e IKAP-it nxjerr vendimin me numër protokoll 469 të datës 18.12.2020, më të cilin serish aprovohet kërkesa e ankuesit për punë sekondare (20 orë në javë) prej datës 18.12.2020 deri në një vendim tjetër .

Agjencia Kundër Korrupsionit bazuar në kërkesën e datës 12.03.2022 të zyrtarit të personelit të IKAP-it, përmes shkresës më numër protokoll DLK 0203/2278/22 të datës 26.05.2022 ka propozuar që Drejtorja e Përgjithshme të IKAP-it të filloj procedurën disiplinore ndaj ankuesit, me arsyetimin së i njëjti nga data 01.10.2017 deri me datë 18.12.2020 ka mbajtur dy vende të punës me pagë primare në kundërshtim me nenin 3 të Udhëzimit Administrativ për Pagat e Nëpunësve të Shërbimit Civil të Kosovës nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të IKAP-it, bazuar në kërkesën e Agjencisë Kundër Korrupsionit, më datë 30.06.2022 ka parashtruar në Komisionin Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme kërkesën për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, ndërsa Komisioni Disiplinor me Vendimin me Nr.1367/2022 të datës 29.08.2022 ka shpall përgjegjës ankuesin lidhur me shkelje disiplinore të rëndë sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3, 3.7. 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke shqiptuar masën disiplinore "*ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 4 vjeçare*".

Kundër këtij vendimi, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, i cili më Vendimin A.nr.827/2022 të datës 22.11.2022 ka anuluar Vendimin me Nr.1367/2022 të datës 29.08.2022 të Komisionit Disiplinor, dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme në riprocedurë ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rënda disiplinore të parapara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3,

3.7, 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe i ka shqiptuar masën disiplinore *“ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 4 vjeçare”*.

Ankuesi në ankesën e parashtruar kundër Vendimit me Nr.2100/2022 të datës 23.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pretendon se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë si dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe me aplikim të gabuar të dispozitave procedurale dhe materiale. Shton se iniciuesi i procedurës disiplinore ka pas për obligim të bëjë kualifikimin e shkeljeve disiplinore e jo të trajtoj çështje që dalin jashtë pikave/çështjeve për të cilat ka qenë i obliguar. Ankuesi me tej ka pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e vendimmarrjes gabimisht i është referuar Udhëzimi Administrativ Nr.3 për Pagat e Nëpunësve të Shërbimit Civil të Kosovës nga Buxheti i Konsoliduar të Kosovës sepse ky udhëzim i referohet vetëm pagave nga buxheti i Kosovës, më asnjë provë nuk ka rritur të argumentojnë së ankuesi ka bërë shkelje të detyrave të punës lidhur me mos përmbushjen e detyrave të tij të punës, dhe së nuk ka marrë parasysh faktin së ankuesi është person me aftësi të kufizuara rrjedhimisht sipas ekspertizës mjekësore ankuesi është i paktë 50% për punë administrative dhe 100% për punë fizike. Propozon që Këshilli ta aprovoj ankesën dhe të anuloj Vendimin Nr.2100/2022 të datës 23.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se për periudhën kohore për të cilën ankuesi është shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore, ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020, ndërsa nga data 10.07.2020 është i zbatueshëm Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, e në pajtim me të cilin ligj është bërë iniciimi i procedurës disiplinore dhe është vendosur lidhur me përgjegjësinë disiplinore të ankuesit.

Bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil përcaktohej se : *“ Nëpunësit civilë duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesi. Nëpunësit civilë veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit në fuqi për shmangien e konfliktit të interesit”* , Ndërsa sipas Rregullores (QRK) - Nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës gjegjësisht me nenin 15 parashihej së: *“ Me veprimtari të jashtme të nëpunësit civil kuptojmë çdo lloj angazhimi të rregullt ose të kohë pas kohshëm jashtë institucionit me pagesë ose pa pagesë. Nëpunësi civil nuk duhet të angazhohet në një veprimtari të jashtme, që pengon kryerjen e detyrës së tij zyrtare dhe që cenon në çfarëdo mënyre, realizimin e objektivave të institucionit. 3. Nëpunësi civil për angazhimin e jashtëm duhet t'i njoftoj paraprakisht udhëheqësin drejtues dhe njësinë e personelit. Ndërlidhur me këtë Kolegji ju referua edhe nenit 5 të Rregullores 05/2010 për Orarin e Punës më të cilin paracaktohej se: 1. Nëpunësit civil kanë të drejtë në orar të shkurtuar të punës, i cili llogaritet në baza javore ose vjetore, ku orari i punës është me i shkurtër se orari i një nëpunësi civil më orar të plotë. 2.Orari i shkurtuar i punës mund të jetë minimum tetë (8) orë pune në javë dhe maksimumi tridhjetepesë (35) orë pune në javë. 3. Pagesa, pushimi dhe kushtet e tjera për stafin më orar të shkurtuar të punës ndryshojnë nga stafi me orar të plotë të punës, në raport me numrin e orëve të punës. ...*

Lidhur me shqyrtimin e themelësisë së pretendimeve ankimore të ankueses Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë referuar procedurës dhe

përgjegjësishë disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht nenin 45 me të cilin përshihet së :“ ... Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”, nenin 46 më te cilin thuhet se: 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i delur në punë.”

Bazuar në përcaktimin ligjor si me sipër, Kolegji konstaton së marrëdhënia e punës në shërbimin civilë është marrëdhënie primare dhe së nëpunësi civil mund të angazhohet në veprimtari/punë jashtë shërbimit civil vetëm në rast së ky angazhim nuk sjell rrethana të konfliktit të interesit në raport me ushtrimin e punës në shërbimin civil dhe nuk pengon kryerjen e detyrës së tij zyrtare apo realizimin e objektivave të institucionit. Për me tepër Kolegji thekson faktin marrëdhënia e punës në shërbimin civil ushtrohet me orar të plotë të punës, ose me orar të shkurtuar në rast të sëmundjes apo pa aftësisë punuese nëpunësit civil të konstatuara nga organi kompetent.

Andaj, ndërlidhur me konstatimin si me lartë dhe bazuar në shkresat e lëndës Kolegji verën së ankuesi punën në shërbimin civil në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Administratë pranë Institutit të Kosovës për Administratë Publike, e ushtron si punë sekondare që nga korriku 2017 e tutje, ndërsa angazhimin e tij në Kolegjin Privat AAB (si institucion jopublik/jo buxhetor) e ushtron si punë primare dhe me orar të plotë, fakt ky i konfirmuar përmes shkresës Ref.nr.251/2021 të datës 13.04.2021 të lëshuar nga Kolegji AAB ku sipas përmbajtjes citohet “

..... është i angazhuar si profesor i rregullt në këtë kolegji dhe ka kontratë valide nga data 01.10.2027 deri më datë 30.09.2021 me mundësi vazhdimi”,

Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesi posedon ekspertizë mjekësore sipas të cilës ankuesi është përherë i paaftë për 50% për punë administrativ, ndërsa 100% i paaftë për punë fizike dhe së i njëjti sipas kartelës së nëpunësit civil nga muaji gusht 2019 deri dhjetor 2020 (përgjashtimisht shkurt-gusht 2019) ka marrë pagë të plotë nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe nga Kolegji Privat AAB, veprime këto që në vlerësimin e Kolegjit bien ndesh me nenin 28 dhe 29 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, më të cilin përshihet së: “1. Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë veprimtari profesionale të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, administratorit të falimentimit, ekspertit të licencuar, konsulentit ose agjentit të personave juridikë si dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër”.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar së ankuesi deri me datë 18.12.2020 nuk kishte përcjell në ministrinë përgjegjëse për administratë publike dhe Thesarin e Kosovës formularët përkatës lidhur me deklarin e pagës primare dhe sekondare, edhe pse bazuar në përshkrimin e detyrave të punës së Drejtorit të Departamentit të Administratës i njëjti është përgjegjës për ndërmarrjen e veprimeve lidhur me çështjet financiare/buxhetore, prokurimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, kështu që mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson së ankuesi nuk ka përmbushur detyrat e tij të punës, dhe si pasojë veprimet e tilla përbejnë shkelje disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me pretendimin ankimor së iniciuesi i procedurës disiplinore ka pas për obligim të bëjë kualifikimin e shkeljeve disiplinore e jo të trajtoj çështje që dalin jashtë pikave/çështjeve për të cilat ka qenë i obliguar, Kolegji ka analizuar vendimin e kundërshtuar me ankesë dhe si rrjedhojë ka gjetur së Komisioni Disiplinor në ri procedurë nuk ka trajtuar çështje tjera që janë jashtë çështjeve/shkeljeve të përfshira me kërkesën e datës 30.06.2022, edhe pse Kolegji verën së në kërkesën për inicim të procedurës disiplinore të datës 14.12.2022 janë përshirë çështje disiplinore që nuk kanë qenë pjesë e kërkesës së datës 30.06.2022, kështu që pretendimi mbi këtë bazë ankimore nuk qëndron.

Po ashtu Kolegji konstaton së është i pabazuar perëndimi ankimor së Komisioni Disiplinor me rastin e vendimmarrjes gabimisht i është referuar Udhëzimi Administrativ Nr.3 për Pagat e Nëpunësve të Shërbimit Civil të Kosovës nga Buxheti i Konsoliduar të Kosovës, ngase Kolegji nuk ka gjetur së Vendimi Nr.2100/2022 i datës 23.12.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, bazohet në ndonjë dispozita ligjore të këtij udhëzimi.


Bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson së Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.2100/2022 i datës 23.12.2022, ka konstatuar më mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe po ashtu drejtë ka zbatuar ligjin material, rrjedhimisht ka cilësuar drejt veprimet e ankuesit si shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4 të 3.1, 3.3, 3.7, 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe së masa disiplinore e shqiptuar është në proporcion me shkeljet disiplinore të konstatuar, përkatësisht Komisioni Disiplinor lidhur me këtë çështje juridiko administrative ka vepruar në pajtim me nenin 45 dhe nenin 50 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar i me lart, e duke bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.152/2023

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Kosovës për Administratë Publike;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

